

**LIGJ**  
**Nr. 24/2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 270, DATË 22.4.2010 “PËR TË DREJTËN E PRIVATIZIMIT TË TRUALLIT SHTETËROR NË PËRDORIM DHE PËR TAKSËN MBI TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË TIJ”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 270, datë 22.4.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

**Neni 1**

Në nenin 2 pika 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) trojet e paprivatizuara, mbi të cilat janë ndërtuar ndërtesa, në bazë të lejeve të ndërtimit të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore, pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, sipas genplaneve në kohën e lëshimit të lejes së ndërtimit, si dhe trojet e objekteve apo ndërtesave, ish-pronë e ish-kooperativave bujqësore, shitja e të cilave është realizuar nga ish-kooperativat bujqësore apo organet e qeverisjes vendore;”.

**Neni 2**

Në nenin 15 pika 1, fjalët “brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 31.12.2012”.

**Neni 3**

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 fjalët “brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 1.7.2012”.

2. Në pikën 3 fjalët “pas gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “pas datës 1.7.2012”.

3. Në fjalinë e fundit të këtij neni, fjalët “pas një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “pas datës 31.12.2012”.

**Neni 4**

Kërkesat e paraqitura nga individët për pagesë të menjëhershme, të cilët përfitojnë ulje të vlerës së truallit, sipas nenit 18 të ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010, dhe kontratat e shitjes së truallit do të konsiderohen të vlefshme dhe pas afatit të mëparshëm, deri në afatin e përcaktuar në nenet 2 dhe 3 të këtij ligji.

**Neni 5**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.3.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7368, datë 5.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**